



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 158/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik për shkak të vendosjes së posterave në vendet publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 05.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.10.2013, nga LVV, me të cilën pretendohet se me datën 03.10.2013 në ora 00:30 se posterat e kandidatit për kryetar komune nga subjekti politik PDK janë vendosur në muret e Kalasë së Qytetit, e cila konsiderohet monument historik. Parashtruesi i ankesës me këtë pretendon se është bërë shkelje ligjore nga ana e PDK-së duke u bazuar në Nenin 33 pika b) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 dhe nenit 3 pika b) të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se posterat e kandidatit për kryetar komune nga subjekti politik PDK në Kaçanik janë të vendosur në muret e Kalasë të Qytetit nuk qëndrojnë ngase nga fotografit e bashkangjitura si provë nga parashtruesi i ankesës PZAP-i konstaton se posterat e kandidatit të lartpërmendur, nuk e janë të asaj të natyre që dëshmojnë se posterat gjenden në objektin e Kalasë andaj një pretendim i tillë është i pabazuar, në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

Anr. 158/2013 më datën 05.10.2013

**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda një-etekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*